

## FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

### Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.a

Durrës, 10/09/2018

#### “Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD”

Për: “**ADEL CO**” shpk, NIPT : L22117021M me adresë: Rruga:”Muhamet Gjollështa”, Zogu Zi, Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim - sherbime”.

Numri i references se procedures/lotit: 65462-04-26-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

- Objekti: “**Sherbimi i printimit dhe zarfimit të faturave për nevojat e UKD**”
- Fondi limit: 5'500'000 (Pesë milion e pesëqind mijë) Leke pa T.V.SH.
- Burimi i te ardhurave: Te ardhurat e U.K.D Sh.a
- Kohezgjatja e kontrates: **12 muaj nga data e lidhjes se kontratës**
- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kane qënë pjesëmarrës në procedurë 2 (dy) ofertues si me poshte:

- 1- **Adel co shpk**, me nipt L22117021M, me vlere te ofruar:
  - pa TVSH është 5'316'344 (pese milion e treqind e gjashtembedhjete mije e treiqnd e dyzet e kater) lekë.
  - meTVSH është 6'379'612,8 (gjashte milion e treqind e shtatedhjete e nente mije e gjashteqind e dymbedhjete presje tete) lekë.
- 2- **ADPSS shpk**, me nipt L11518003F, me vlere te ofruar:
  - pa TVSH është 3'769'771,2 (tre milion e shtateqind e gjashtedhjete e nente mije e shtateqind e shtatedhjete e nje presje dy) lekë.
  - meTVSH është 4'523'725,44 (kater milion e peseqind e njezet e tre mije e shtateqind e njezet e pese presje dyzet e kater) lekë.

Eshtë skualifikuar operatori ekonomik si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “ADPSS shpk” është skualifikuar për arsye se:

Pasi u mor në shqyrtim nga ana e KVO-së, dokumentacioni justifikues i Ofertes Anomalisht te Ulet paraqitur nga operatori “ADPSS” sh.p.k u vlerësua :

Argumenti i paraqitur nuk është në përputhje me ligjin dhe nuk garanton KVO për përmbushjen me sukses të objektit që prokurohet.

Në nenin 56 të ligjit “Për Prokurimin Publik”, I ndryshuar përcaktohet

Kur KVO vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, I kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqes me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të vecanta të ofertës, për:<sup>1</sup>

- a. Anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara.
  - b. Zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve,për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve.
  - c. Originalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi.
  - d. Zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.
1. AK i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe ne bazë të informacionit të paraqitur KVO mund ta refuzojë ofertën kur edhe pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në tëgjithë elementët e saj.

**Së pari**, ju bëjmë me dije se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria ADPSS në përmbushje të vërtetimit të bazës material letër, nuk mund të merret në konsideratë për arsyet si më poshtë vijon:

- a. Dokumentat e paraqitura janë në gjuhën angleze, për pasojë nuk mund të merren në konsideratë. Sikurse është specifikuar në dokumentat e tenderit, gjuha që ndiqet për zhvillimin e kësaj procedure dhe dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i përkthyer në gjuhën shqipe.
- b. Përsa i përket deklaratave të zhdoganimit për blerjen e bazës material letër, asnjëra prej tyre nuk mund të merret në konsideratë pasi, njëra nga llojet e letrave që është specifikuar në deklaratë është “letër shtypi në role 6777kg( 80gsn)”, ndërkohë që lloji i letrës për realizimin e kontratës që prokurohet është “laserbond 90gsn”. Pra, sikurse evidentohet, kemi të bëjmë me një lloj tjetër letre. Përsa i përket zërit tjetër të kësaj deklarate zhdoganimi në kushtet që kjo deklaratë nuk ka të bashangjitur një faturë të përkthyer në gjuhën shqipe, vlera e të cilave ( te të dyja llojeve e sasive e letrave të zhdoganuara) të përputhet me vlerën e deklaruar ne deklaratën e

zhdoganimit, kur qartëson dhe bind KVO që letra është njësoj si e kontratës që prokurohet. Pra, përse i përket letrës tjetër në këtë deklaratë zhdoganimit, nuk mund të nxirret as gramatura apo lloji i letrës dhe as vlera monetare e kësaj letre në mënyrë që të shërbejë për llogaritjen e vlerës së bazës materiale kryesore që është letra.

<sup>1</sup>Ndryshuar me ligjin nr.182/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9463, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

Për më tepër, ADPSS nuk ka bërë një përlllogaritje të sasisë së letrës që mund të nevojitet për realizimin e produktit në mënyrë që të kalkulohet kostoja në raport me sasinë. Pra, përlllogaritja e bërë nga ADPSS është e pa argumentuar në mynyrë që të kuptohet edhe nga KVO se si është ndërtuar ana ekonomike e kësaj oferte, duke krijuar kështu dyshime të arsyeshme dhe të bazuara. Gjithashtu ka përfshirë skarcitet teknik 2%, pa specifikuar nëse 2% është për njërën makineri apo për të gjitha makineritë e kërkuara në tender, duke mos krijuar kështu bindje për këtë pikë.

Dhe në qoftë se e marrim të mirëqenë që letra është e saktë ( pra nga 80gr, në 90 gr) prap përlllogaritja e cmimit është bërë me cmimin në Greqi dhe nuk është llogaritur transporti, agjensitë doganore në Greqi dhe Shqipëri si dhe pagesat e tjera doganore.

Pra, vlerat e paraqitura nga kjo shoqëri nuk janë përlllogaritur në mënyrë transparente dhe janë të pavërtetuara nga dokumentacioni apo faktet mbështetëse.

**Se dyti:** Përse i përket përlllogaritjes së zerit Kosto puntore printimi i faturave, referuar vlerës së përlllogaritur nga ADPSS është 0.20 lekë/faturë. Vlerë totale për të gjithë faturat : 0.20x966.608 fatura = 193,321 leke në total për 12 muaj dhe 16,110 leke/ muaj.

Në kushtet që në DST janë kërkuar minimalisht 2 makineri printimi dixhitale me ngjyra do të thotë se nevojiten minimumi 2 punonjës si operatorë makinë, specialist IT (për përpunimin dhe ndarjen e fileve sias kabinave, zonave, etj.) punonjës për prerjen e letrës, punonjës për paketimin, punonjës për transportin, etj, dhe paga minimale e përcaktuar me VKM është 24,000 lekë bruto, KVO mendon se vlera prej 16,110 lekë/muaj për pagimin e punonjësve (pa përfshirë këtu punonjësit për zarfimin selfmail që operatori i ka përlllogaritur në zë tjetër shpenzimesh), është një vlerë e cila është nën minimumin jetik të përcaktuar me VKM dhe për më tepër, kjo vlerë është përlllogaritur pa i shtuar edhe pagesën për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore që është një detyrim ligjor. Gjithashtu mendojmë që ADPSS nuk ka marrë në konsideratë edhe faktin që puna pas orës 22:00 -06:00, apo puna në ditën e shtunë, apo dielë, apo në rastet e festave zyrtare paguhet me shtesë mbi pagë, duke u bërë kështu një rrezik potencial për shkeljen e legjislacionit të punës në fuqi.

Pra, në kushtet që në dokumentat e tenderit janë kërkuar minimumi 10 punonjës për kryerjen e këtij procesi (dhe operatorët ekonomike nuk e kanë kundërshtuar por e kanë pranuar që ky është numri minimal për kryerjen e këtij procesi pune), vlera e përcaktuar për pagimin e punonjësve krijon bindjen KVO-së se operatori ekonomik krijon kushte për keqpagimin e puntorisë. Duke qënë se është një proces pune i cili kërkon pune fizike dhe në ambient industrial, ky operator nuk paraqet asnjë dokument apo fakt për respektimin e kushteve minimale në punë siç mund të jenë mjete për mbrojtjen e shendetit dhe sigurisë në punë dhe rrjedhimisht asnjë shpenzim të

justifikuar përsa i përket kësaj pike.

Sikurse mund të evidentohet edhe nga tabela e paraqitur, vlerësimi i puntorisë është në njëjtën vlerë me materialet e konsumit apo me pjesët e këmbimit (20 lekë/fature) apo me e pak paguar se amortizimi i pajisjes së zarfimit, gje e cila e thekson edhe me shume bindjen e KVO për keqpagimin e puntorisë. Theksojmë se përveç legjislacionit të punës, edhe vete legjislacioni I prokurimit publik e mbron keqpagimin e punetorisë duke kërkuar edhe detajim të kësaj pikë.

**Së Treti:** Në shpjegimin e bërë, OE ka përfshirë një zë “Provigjione”. Theksojmë se ky term nuk është në gjuhën shqipe dhe është i paqartë për tu kuptuar dhe nuk ka përcaktuar se çfarë përfshin ky zë i ndërtimit të ofertës ekonomike.

**Së Katërti:** Përsa i përket kushteve favorizuese apo zgjidhjeve teknike të pretenduara nga shoqëria ADPSS në pikën b të argumentimit të tyre ku pretendon se fakti që kompania ka tre makineri printimi me ngjyra ju bëjmë me dije se ky nuk është aspak një kriter favorizues, pasi këto makineri janë kërkuar për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë si parakusht kualifikimi. Pra, ky kriter ishte një kriter minimal i përcaktuar në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet favorizues për realizimin e kontratës që prokurohet. Përsa i përket pretendimit se procesi selfmail gjithashtu është favorizues sepse realizohet nga pajisje gjermane MBO-HHS, lidere për këto sisteme, theksojmë se në argumentimin e paraqitur shoqëria juaj nuk ka paraqitur ndonjë dokument që disponon pikërisht këto makineri për realizimin e këtij procesi, për pasojë nuk mund të konsiderohet si kusht favorizues.

**Së pesti:** Përsa i përket pikës d të argumentimit të cmimit të paraqitur nga ADPSS, mbi zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku kryhet puna apo shërbimi, ADPSS nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbi zbatimin e kushteve në punë. Në përmbushje të kësaj pike ADPSS nuk ka paraqitur asnjë dokument provues mbi detyrimet që ka për mbrojtjen në punë (psh fatura për blerjen e pajisjeve për mbrojtjen nga zhurma e makinerive, foto të sistemit të ngrohjes-ftohjes në ambientet e punës, etj).

Përsa më sipër, ndërtimi i ofertës ekonomike të paraqitur nga ky operator nuk krijon bindjen për realizimin me sukses të kontratës që prokurohet.

#### **Pra kualifikohen operatori ekonomik si më poshtë:**

**Adel co shpk**, me nipt L22117021M, me vlere të ofruar:

- **pa TVSH është 5’316’344 (pese milion e treqind e gjashtembedhjete mije e treiqind e dyzet e kater) lekë.**
- **meTVSH është 6’379’612,8 (gjashte milion e treqind e shtatedhjete e nente mije e gjashteqind e dymbledhjete presje tete) lekë.**

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “Adel Co” shpk se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **5’316’344** (pese milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 28/08/2018

Operatori ekonomik “ADPSS shpk” paraqiti ankesë pranë Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a me pretendimin se nuk kishte marrë nga UKD një kërkesë në lidhje me argumentimin e ofertes anomalisht të ulët. UKD sh.a pranoi ankesën dhe rivendosi Operatorin në afat për argumentimin e OAU. Ujesjelles Kanalizime Durrës nuk mori parasysh argumentimin dhe shpalli fitues Adel Co shpk.

